

STATUTI
I SHOQERISE “AMERICAN COMPUTERS” SH.P.K
(me ortak të vetëm)

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; - “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

1. Seldi ZENELAJ, shtetas shqiptar, atësia Enver, lindur më 04.06.1984, në Fier, Shqiperi dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e Ortakut të vetëm të Shoqërisë “American Computers” SH.P.K, mbajtës karte identiteti Nr.I40604125S, lëshuar nga shteti shqiptar me dt 08.01.2021 , e vlefshme deri më date 07.01.2031 , me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “American Computers” SH.P.K sot me date 24.02.2023 hartoi këtë statut të Shoqërisë “American Computers” SH.P.K.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1. Sot me date 24.02.2023 themelohet shoqëria “American Computers” SH.P.K.
- 1.2. Shoqëria do të paraqitet me emrin “American Computers” SH.P.K. Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjitha rregjistrimet, transaksionet, marëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo dhe shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë edhe brënda vendit.
- 1.3. Shoqëria vepron sipas legjilacionit shqiptar në fuqi.
- 1.4. Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e përcaktuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë.
- 1.5. Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjilacionin shqiptar dhe kanë karakter të detyrueshë, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.
- 1.6. Shoqëria është themeluar nga Z. Seldi Zenelaj, i cili është ortak i vetëm i shoqërisë.



Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme :

- Eksport-Import si dhe tregti me shumice dhe pakice te paisjeve kompjuterike, pjese te ndryshme kembimi,aksesore,servis te paisjeve kompjuterike. EksportImport si dhe tregti me shumice dhe pakice te pajisjeve elektronike/informatike, telekomunikacionit,sisteme vezhgimi, akseskontrolli, sisteme kunder zjarri,UPS ,pjese te ndryshme kembimi,aksesore,servis te pajisjeve elektronike.Shitje me shumice dhe pakice te mjeteve kancelarike. Instalim,sherbim, mirembajtje te sistemeve kompjuterike, telekomunikacioni, sisteme vezhgimi, akses kontrolli,sisteme UPS, sistemezjarri, sisteme elektrike te fuqive te larta dhe te mesme, aplikim grafik.

Neni 3.

Selia e shoqërisë dhe degët

3.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën Rruga ‘Suljeman Delvina’, Nr. Pasurie 4/684-N5, pranë shkollës Vasil Shanto.

3.2 Transferi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendm të ortakut të vetëm.

3.3 Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.

3.4. Zyrat, filialet, degët apo agjensitë krijohen me Vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë, I cili organizon punën dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesin ligjor.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë

4.1. Kohëzgjatja e shoqërisë “American Computers” Sh.P.K. është me një afat të pacaktuar.

4.2. Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakut të vetëm

4.3. Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të ortakut të vetëm.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 11,511,000 Lekë (njëmbëdhjetë million e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm :

Ortaku themelues Seldi ZENELAJ, Zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 11,511,000 lekë e cila përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, shumë e cila do të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë në Tiranë në valutën Euro konvertuar me kursin e ditës nga Banka e Shqipërisë 115.111/euro.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me miratimin e ortakut të vetëm.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfundimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

13.1. Shoqëria do të drejtohet nga administratori i vetëm Seldi ZENELAJ, shtetas shqiptar, atësia Enver, lindur më në Ballsh, Shqipëri dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike, për të vepruar me cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, "AMERICAN COMPUTERS" SH.P.K. , mbajtës karte identiteti Nr. I40604125S lëshuar nga shteti shqiptar me dt 08.01.2021 e vlefshme deri më datë 07.01.2031.

Administratori i shoqërisë emërohet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajn bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblën e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse Ortaku i vetëm emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja – Riorganizimi i shoqërisë



Neni 17

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i vetëm

Neni 18

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Ortakut të vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj në perputhje te plotë me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Neni 21

Fitimi që shpërndahet

Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahet vendoset rast pas rasti nga Ortaku i vetëm i shoqërisë sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjëndjen financiare të shoqërisë.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi menjëhere dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortaku i vetëm i shoqërisë.

ORTAKU

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

* AMERICAN COMPUTERS* SH.P.K.

SELDI ZENELAJ

Handwritten signature of Sel迪 Zenelaj in blue ink, consisting of a cursive script of the name and a checkmark-like flourish below it.